



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0587

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Ageo&Co” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-tender Blerja e pajisjeve teknike - Dron “me nr. të prokurimit:”210-23-6493-1-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapesinor, me datën 12.10.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Ageo&Co” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 16.08.2023 (me numër protokolli 587/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-tender Blerja e pajisjeve teknike - Dron” me nr. të prokurimit: “210-23-6493-1-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapesinor.

2. Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 23.06.2023, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapesinor, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-tender Blerja e pajisjeve teknike - Dron” me nr. të prokurimit: “210-23-6493-1-2-1”. Nderkaq me datën 01.08.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE "Ageo&Co" SH.P.K me datën 03.08.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapesinor me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE "Ageo&Co" SH.P.K. . lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-tender Blerja e pajisjeve teknike - Dron" me numër të prokurimit: 210-23-6493-1-2-1 inicuar nga Autoriteti Kontraktues.

AK ne vendim ka kërkuar të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin për dhënie të AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-tender Blerja e pajisjeve teknike - Dron" me numër të prokurimit: 210-23-6493-1-2-1.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Ageo&Co" SH.P.K. me datën 16.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 587/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 42.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 28.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Ageo&Co" SH.P.K.

I. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Ageo&Co" SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 16.08.2023 (me numër protokollit 587/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ri-tender Blerja e pajisjeve teknike - Dron" me nr. të prokurimit: "210-23-6493-1-2-1", inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapesinor.

II. Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

OE ankues pretendon që AK e ka eliminuar atë pa të drejtë dhe ka shpallur fitues një OE që nuk është i përgjegjshëm. Teskti i plotë i pretendimeve të OE ankues është prezantuar në sesionin 2

të këtij raporti, andaj këtu do t'i referohemi atyre për aq sa është e nevojshme.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që me ofertën e tyre e ka përmbushur kërkesën e tenderit: *“OE duhet të ketë staf një Gjeograf ose Gjeodet të diplomuar ose master, te kete pervoje pune se paku 3 vite pas diplomimi.*, duke prezantuar diplomën e Vllaznim Vuçitërnës. OE ankues ka argumentuar që kërkesa e DT nuk e ka specifikuar që gjeodeti duhet të jetë “inxhinier i diplomuar i gjeodezisë”, prandaj diploma e paraqitur nga OE ankues është në përputhje me kërkesën në fjalë.

Duke qenë se kjo çështje është trajtuar edhe në Raportin e Ekspertit me Nr. 2023/0174, të datës 18.04.2023, ku është theksuar që “z.Vllaznim Vuçitërna ka kualifikim shkollor sipas kërkesës së përcaktuar nga AK”, eksperti shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i bazuar.



Pretendimi 2

OE ankues pretendon që garancioni i paraqitur nga ai me ofertë i plotëson kërkesat e DT. Sipas OE ankues edhe pajisja dhe garancioni i paraqitur nga OE i rekomanduar për kontratë është nga i njëjti prodhues dhe diler.

Eksperti shqyrtues i ka ekzaminuar të dy dokumentet (që janë paraqitur më poshtë) dhe siç mund të shihet ato janë lëshuar nga e njëjta kompani nga Kroacia “AVITEH”. Në të dyja rastet kompania ka ofruar garancionin e njëjtë për produktet e saj, pra 24 muaj për pjesët elektrike, ndërsa 12 muaj për bateri.



AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.
ul. Matka Baštijana 41, 10000 Zagreb, Hrvatska
info@aviteh.hr • www.aviteh.hr

FROM:

AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.
ul. Matka Baštijana 41
10000 Zagreb
OIB: 74228338976

TO:

Gjeo-Projekt SH.P.K
Rr.UÇK-së, pn
21000 Rahovec

DJI Warranty

Company AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o., as official dealer for DJI drones and equipment, confirms warranty periods for next DJI products:

DJI Matrice 300 system (excluding batteries) - 24 months
DJI TB60 and WB37 batteries - 12 months.

In Zagreb, 13.07.2023.

AVITEH
Audio Video Tehnologije d.o.o.
ZAGREB, OIB: 74228338976

AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o., ul. Matka Baštijana 41, 10020 Zagreb, Tel.: +385 1 889 5552
IBAN: HR2223600001102294879, OIB: 74228338976

Društvo je upisano u Registar Trgovačkog suda u Zagrebu pod brojem Tt-15/18517-1, MBS 080805145
Temeljni kapital društva iznosi 20.000,00 kuna i uplaćen je u cijelosti.



AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.
Ulica Matka Baštijana 41, 10000 Zagreb, Hrvatska
info@aviteh.hr • www.aviteh.hr

Warranty Period

We AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o. with OIB: 74228338976, with address Bastijanova 41, 10 000 Zagreb, Croatia hereby declare that warranty for offered DJI product is:

24 months for all electrical parts, except batteries which are 12 months

Marko Arsenovic, Head of Sale

AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.

Tel: +385 1 2100 402

Mob: +385 99 3645 409

Mail: marko@aviteh.hr

Web: www.aviteh.hr

Zagreb, Croatia; date: 01.03.2023

AVITEH
Audio Video Tehnologije d.o.o.
ZAGREB, OIB: 74228338976

AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o., Ulica Matka Baštijana 41, 10020 Zagreb, Tel: +385 1 889 5552
IBAN: HR2223600001102294879, OIB: 74228338976

Društvo je upisano u Registar Trgovačkog suda u Zagrebu pod brojem T1-15/18517-1, MBS 080805145
Temeljni kapital društva iznosi 20.000,00 kuna i uplaćen je u cijelosti.



AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.
Ulica Matka Baštijana 41, 10000 Zagreb, Hrvatska
info@aviteh.hr • www.aviteh.hr

AUTHORIZATION CERTIFICATE

We AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o. with OIB: 74228338976, with address Bastijanova 41, 10 000 Zagreb, Croatia hereby declare that AGEO & CO SH.P.K. With NUI 810840620 represented by Vllaznim Vuçitërna-Menager with address L. e Spitalit, Muharrem Fejza Prishtine 10 000 Kosovo is our Authorized Dealer and Service Center in Kosovo. The product range includes DJI Drones and the related surveying accessories.

They have the complete ability and authority to participate in all government or private tender and sales, to bid, to negotiate, to sign contracts, to sell, to service and apply for any necessary approvals and permissions on our behalf as our authorized dealer of DJI Drones.

Marko Arsenovic, Head of Sale

AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.

Tel: +385 1 2100 402
Mob: +385 99 3645 409
Mail: marko@aviteh.hr
Web: www.aviteh.hr

Zagreb, Croatia; date: 01.03.2023

AVITEH
Audio Video Tehnologije d.o.o.
ZAGREB, OIB: 74228338976

AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o., Ulica Matka Baštijana 41, 10020 Zagreb, Tel.: +385 1 889 5552
IBAN: HR2223600001102294879, OIB: 74228338976

Društvo je upisano u Registar Trgovačkog suda u Zagrebu pod brojem Tt-15/18517-1, MBS 080805145
Temeľni kapital društva iznosi 20.000,00 kuna i uplaćen je u cijelosti.

Eksperti shqyrtues vlerëson që edhe ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 3

OE ankues pretendon që disa prej referencave të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk i përmbushin kërkesat e DT. Specifikisht, OE ankues ka kontestuar vlefshmërinë e dokumenteve të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë për furnizimet për Policinë e Kosovës (81,180 Euro), Arsim Kastrati (15,150 Euro) dhe Alban Sinani (2,000 Euro).

Duke pasur parasysh kërkesat e DT si më poshtë, nga ekzaminimi i shkresave relevante, eksperti shqyrtues vlerëson që dokumenti i paraqitur në lidhje me projektin **Furnizim me drona** në vlerë prej 81,180 Euro, me AK Policia e Kosovës, nuk mund të konsiderohet plotësisht në përputhje me kërkesat e DT, pasi që kërkesa në fjalë ka qenë që **“OE duhet të ofroj dëshmi se gjatë tri viteve të fundit, deri në njoftimin për kontratë, ka kryer me sukses furnizime të natyrës së ngjajshme [...]”** dhe një gjë e tillë të dëshmohet me **“kopjen e referencave ose procesverbaleve të pranimit përfundimtar të furnizimeve [...]”**. Meqenëse një kontratë e tillë është në implementim e sipër, OE i rekomanduar për kontratë e ka të pamundur të paraqesë **“referenca” ose “procesverbale të pranimit përfundimtar të furnizimeve”,** siç kërkohet me DT. Sidoqoftë, AK do të mund të konfirmonte me Policinë e Kosovës vlerën e saktë të furnizimeve, deri në njoftimin për kontratë; dhe të kërkonte një vlerësim për integritetin e furnizuesit, në këtë rast OE të rekomanduar për kontratë. Në të kundërtën, në mungesë të një dëshmie të tillë mund të konstatohet që OE nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të DT.

Po ashtu, furnizimet e bëra për Alban Sinanin, për projektin **Furnizim me instrument gjeodezik Leica 1103 plus dhe aksesoret shtesë**, me vlerë prej 2,000 Euro

| | Kapaciteti teknik dhe profesional | Dëshmia e kërkuar dokumentare: |
|--|---|---|
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 | Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se gjatë tri viteve të fundit deri në njoftimin për kontratë ka kryer me sukses furnizime të natyrës së ngjajshme, në vlerë jo më të vogël se 63,000.00 euro. | Operatori ekonomik duhet të ofroj listën e kontratave të ngjajshme të realizuara gjatë tri viteve të fundit deri në njoftimin për kontratë. E dëshmuar me kopjen e referencave ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të furnizimeve duke treguar vlerën, datën, dhe vendodhjen e projekteve të furnizimeve në lëmin e kërkuar në vlerë jo më të vogël se 63,000.00 euro. Lista duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe vërtetuar nga operatori ekonomik. |

Rrjedhimisht, vlerësoj që ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 4

Pretendimi tjetër i OE ankues është që AK e ka shkelur LPP duke i kërkuar OE të rekomanduar për kontratë katalogun, pas hapjes së ofertave.

Sipas Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik, kërkesa për dorëzim të katalogut nuk është në kundërshtim me LPP. Sipas udhëzimeve të ofruara në këtë akt, tek pjesa 10. **Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve**, AK mund të kërkojë informata sqaruese në

rastet kur mungon katalogu.

Problemi

Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu

Si të vepohet?

Mund të kërkohen informata sqaruese

Neni i LPP-së

69

Sidoqoftë nga rishikimi i dëshmisë së ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, nuk kam hasur në nënvizimet me ngjyrë për pajisjen e kërkuar, siç është specifikuar në kërkesat e DT, më poshtë.

| | Kapaciteti teknik dhe profesional | Dëshmia e kërkuar dokumentare: |
|--|--|---|
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 | OE duhet të dorëzojë katalog për komisionin e vlerësimit dhe në pjesen e katalogut duhet të ketë të nënvizuar me ngjyrë për paisjen e kërkuar sipas kërkesës së AK. | OE duhet të dorëzojë katalog për komisionin e vlerësimit dhe në pjesen e katalogut duhet të ketë të nënvizuar me ngjyrë për paisjen e kërkuar.(origjinal jo kopje nga interneti) |

Rrjedhimisht, konsideroj që ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 5

Për sa i përket pretendimit për gabimin e OE të rekomanduar për kontratë tek forma e pershkrimit të çmimeve, me ç'rast tek kolona e TVSH-së është paraqitur vlera në vend të %, konsideroj që përgjigjja e dhënë nga AK është e arsyeshme dhe ky pretendim është i papabazuar

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

| NR. I ART | PËRSHKRIMI | NJESIA MATËSE | SASIA | ÇMIMI PËR NJESI PA TVSH € | TVSH (%) | ÇMIMI PËR NJESI ME TVSH € | ÇMIMI TOTAL ME TVSH € | VENDI I ORIGINËS |
|---------------------|--|------------------|-------|------------------------------|-------------|------------------------------|--------------------------|---------------------|
| 1 | Furnizim me dorn dhe Trajnimi i zyrtarit Për përdorim (procedurën e punës) | cope | 1 | 23,559.32 | 4240.68 | 27,800.00 | 27,800.00 | KINA |
| 2 | | | | | | | | |
| ÇMIMI TOTAL ME TVSH | | | | | | | 27,800.00 € | |

Konstatimet e panelit shqyrtues

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e

tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore.

Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj paneli mbështet shpjegimet dhe arsyetimet e ekspertit shqyrtues por megjithatë duke u bazuar në prova dhe fakte të argumentuara dhe konform nenit 59 dhe 72 të LPP të bëjë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e të gjitha ofertave të përgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit. Dhe ndaj OE të rekomanduar për kontratë të kërkoj sqarime konform nenit 10 të udhëzuesit nr.001/2023 për prokurimnt publik, me qëllim të konstatimit dhe vërtetimit të saktë të këtyre fakteve të paraqitura në ankesë dhe raport të ekspertizës.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 dhe 72 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**
- **OE - AGEO & CO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: